REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

P R O J E K T L I G J

Nr. _____, datë _____ 2026

PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7895, DATË 27.1.1995, "KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 81, pikat 1 dhe 2, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Neni 1

Neni 52/b ndryshohet si më poshtë:

"Neni 52/b
Përjashtimi ose ulja e dënimit për bashkëpunimin në hetimin e veprave zgjedhore

Personi që ka kryer një ose më shumë vepra penale të parashikuara në kreun X të pjesës së posaçme të këtij Kodi, ndërpret pjesëmarrjen në veprimtarinë kriminale, kur ajo vazhdon, dhe bashkëpunon me organet e ndjekjes penale, duke dhënë të dhëna të vërteta dhe të rëndësishme për zbulimin e veprës, të bashkëpunëtorëve ose të autorëve të tjerë, mund të përfitojë, me vendim të arsyetuar të gjykatës, uljen e dënimit nën minimumin e parashikuar nga dispozita përkatëse. Gjykata vlerëson kohën, vërtetësinë, rëndësinë dhe rezultatet e bashkëpunimit, rolin e personit dhe rrezikshmërinë e veprës.

Kur roli i personit ka qenë dytësor dhe bashkëpunimi i tij ka qenë thelbësor për zbulimin e veprës ose të autorëve, gjykata mund ta përjashtojë atë nga dënimi.

Organizatori, drejtuesi ose financuesi i veprës, si dhe personi që ka përdorur dhunë ose kanosje, nuk përfiton përjashtim nga dënimi sipas këtij neni."

Neni 2

Neni 326 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 326
Falsifikimi i materialit zgjedhor dhe rezultateve të zgjedhjeve

Falsifikimi, shpërndarja ose përdorimi me dijeni i fletëve të votimit, dokumenteve ose materialeve zgjedhore me të dhëna të rreme, zëvendësimi i të dhënave të sakta me të rreme në procesverbale, tabela ose sisteme elektronike të rezultatit, futja në mënyrë të paligjshme e fletëve të votimit në kuti, heqja ose zëvendësimi i tyre, si dhe leximi, numërimi ose regjistrimi me dashje i votës në

kundërshtim me vullnetin e shprehur në fletën e votimit, me qëllim ndryshimin e rezultatit të zgjedhjeve, përfshirë votat parapëlqyese për kandidatët dhe votat për alternativat në referendum, dënohen me burgim nga një deri në pesë vjet.

Po këto vepra, kur kryhen nga personat që kanë për detyrë administrimin e procesit zgjedhor, ose kur kanë sjellë pasoja të rënda në mbarëvajtjen e votimit, kanë cenuar integritetin e rezultatit apo kanë sjellë pavlefshmërinë e zgjedhjeve, dënohen me burgim nga tre deri në shtatë vjet."

Neni 3

Pas paragrafit të tretë të nenit 327 shtohen dy paragrafë me këtë përmbajtje:

"Kërkimi, marrja ose kontrollimi me dashje pa të drejtë i fotografisë, filmimit ose çdo dokumentimi tjetër të votës së një zgjedhësi, me qëllim verifikimin e mënyrës së votimit ose përmbushjen e një marrëveshjeje korruptive apo të një kërkese të imponuar, dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.

Kërkimi ose kontrollimi me dashje dhe pa të drejtë i shenjës, dokumentit ose provës tjetër të pjesëmarrjes apo mospjesëmarrjes së një zgjedhësi në votim, nëpërmjet kanosjes ose kushtëzimit të punësimit, shërbimit apo përfitimit, me qëllim kontrollin ose ndikimin e paligjshëm të sjelljes së tij zgjedhore, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet. Administrimi, vëzhgimi, auditimi, ankimi dhe hetimi i ligjshëm i procesit zgjedhor nuk përfshihen në këtë paragraf."

Neni 4

Pas paragrafit të tretë të nenit 327/a shtohen tre paragrafë me këtë përmbajtje:

"Plotësimi ose hedhja me dashje e fletës së votimit në vend të një zgjedhësi tjetër, jashtë rasteve dhe kushteve të asistencës së parashikuar nga ligji, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.

Shënimi me dashje, gjatë asistencës së votimit, i një zgjedhjeje të ndryshme nga ajo e shprehur nga zgjedhësi, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.

Lejimi me dashje nga komisioneri zgjedhor i votimit në vend të një zgjedhësi tjetër jashtë rasteve dhe kushteve të asistencës së parashikuar nga ligji ose i ndryshimit të zgjedhjes së tij gjatë asistencës, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet."

Neni 5

Pas nenit 327/a shtohet neni 327/b, me këtë përmbajtje:

"Neni 327/b

Qarkullimi i paligjshëm i fletës së votimit për kontrollin e votës

Sigurimi, nxjerrja ose dorëzimi me dashje i një flete votimi jashtë procedurave të parashikuara nga ligji, si pjesë e një marrëveshjeje për dorëzimin zgjedhësit të një flete të paraplotësuar dhe kthimin e fletës së paplotësuar të marrë prej tij sipas procedurës së votimit, me qëllim kontrollin e votës dhe vazhdimin e këtij mekanizmi, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Kur veprimtaria e parashikuar në paragrafin e parë organizohet ose drejtohet sipas një plani të përbashkët ndaj dy ose më shumë zgjedhësve, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.

Lejimi ose ndihma me dashje e kësaj veprimtarie nga personi përgjegjës për administrimin zgjedhor, duke përdorur funksionin e tij, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet."

Neni 6

Në nenin 328 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në paragrafin e parë, fjalët "Ofrimi ose dhënia e të hollave, të mirave materiale, premtimi për vend pune ose favorizime të tjera" zëvendësohen me fjalët "Premtimi, ofrimi ose dhënia e të hollave, e të mirave materiale, e një vendi pune ose e favorizimeve të tjera".

2. Pas paragrafit të parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Organizimi, drejtimi ose financimi i kryerjes së veprës së parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni, sipas një plani të përbashkët dhe ndaj dy ose më shumë zgjedhësve, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet."

Neni 7

Neni 328/a ndryshohet si më poshtë:

"Neni 328/a
Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore

1. Pjesëmarrja aktive, me dashje, e punonjësit që kryen detyrë shtetërore në shërbimin civil ose ushtron funksion jopolitik në administratën shtetërore, në veprimtarinë ose fushatën zgjedhore të një partie politike, subjekti zgjedhor a kandidati, me qëllim përfitimin ose diskriminimin zgjedhor, në rastet dhe gjatë periudhave kur ligji e ndalon shprehimisht, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

Pjesëmarrja individuale pasive dhe shprehja individuale e bindjeve politike, përfshirë ndërveprimin individual në rrjetet sociale, nuk përbëjnë, vetëm për këtë shkak, vepër penale sipas kësaj pike. Përgjegjësia administrative ose disiplinore vlerësohet vetëm kur parashikohet shprehimisht me ligj. Organizimi ose drejtimi i fushatës, mobilizimi i personelit dhe përdorimi i funksionit ose burimeve publike vlerësohen sipas elementeve të veprave përkatëse të këtij neni.

2. Detyrimi ose organizimi me dashje i nxënësve të arsimit parauniversitar për të marrë pjesë në veprimtari politike ose zgjedhore të një subjekti zgjedhor, nga personi që kryen detyrë shtetërore në arsimin publik ose detyrë a funksion në arsimin jopublik, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

3. Detyrimi, urdhërimi ose kërkesa e shoqëruar me presion, që punonjësi a funksionari publik i drejton një personi duke shfrytëzuar funksionin, autoritetin publik ose varësinë hierarkike, për të marrë pjesë në veprimtari politike a zgjedhore, për të mbështetur ose jo një parti a kandidat, për të votuar në një mënyrë të caktuar ose për të marrë pjesë a jo në votim, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet. Presioni përfshin kërcënimin me masa administrative a disiplinore, humbjen e vendit të punës, mosrinovimin e kontratës, pengimin e karrierës ose cenimin e një të drejte a përfitimi në marrëdhëniet me administratën. Presioni përfshin edhe detyrimin për të publikuar, pëlqyer, komentuar ose shpërndarë përmbajtje politike, ose për të dorëzuar prova të veprimtarisë politike personale apo të personave të tjerë. Këto veprime përfshihen edhe kur presioni ushtrohet tërthorazi nëpërmjet punëdhënësit privat, duke përdorur ose kërcënuar përdorimin e kompetencave publike ndaj tij, me dijeni për qëllimin e këtij presioni.

4. Kërkimi, urdhërimi ose ushtrimi i presionit nga punonjësi a funksionari publik, duke përdorur funksionin, autoritetin ose varësinë hierarkike, që punonjës të tjerë të identifikojnë, regjistrojnë, profilizojnë, kontaktojnë ose rekrutojnë zgjedhës, të plotësojnë lista apo kuota, ose të raportojnë

për bindjet, mbështetjen apo pjesëmarrjen e tyre në votim, me qëllim ndikimin e paligjshëm mbi vullnetin politik ose zgjedhor, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

5. Përdorimi me dashje dhe në kundërshtim me ligjin, nga punonjësi a funksionari publik, i funksionit, autoritetit, burimeve shtetërore, shërbimeve ose kompetencave publike, me qëllim favorizimin ose dëmtimin politik a zgjedhor të një partie politike, subjekti zgjedhor, kandidati apo grupi zgjedhësish, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet. Përfshihen, kur provohen këto elemente, propozimi, miratimi, urdhërimi ose ekzekutimi i paligjshëm i masave administrative, fiskale ose sociale dhe përdorimi i fondeve, prokurimeve, investimeve, kontratave, pasurisë, personelit ose komunikimit institucional. Përfshihen edhe mobilizimi i personelit publik dhe përdorimi i listave, platformave, kuotave ose raporteve për të kushtëzuar punësimin, vlerësimin, promovimin, transferimin, shpërblimin, disiplinën ose vazhdimin e marrëdhënies së punës me sjelljen politike, si dhe zbatimi i këtij kushtëzimi ose i hakmarrjes për të njëjtin shkak. Shkelja vetëm e një afati raportimi, e një kërkese dokumentimi ose e një kufizimi të përkohshëm administrativ, pa elementet e mësipërme, nuk përbën këtë vepër penale. Përgjegjësia për pagesat publike të ndaluara vlerësohet sipas nenit 328/d.

6. Urdhërimi, organizimi ose përdorimi me dashje i kontrollit, inspektimit, verifikimit, hetimit administrativ, masës administrative a sanksionit, ose mosushtrimi e shtyrja e tyre në mënyrë selektive, duke shfrytëzuar funksionin ose autoritetin publik, me qëllim ndëshkimin, shpërblimin ose ndikimin e sjelljes politike a zgjedhore të personit ose të personave të lidhur me të, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

7. Veprat e parashikuara në paragrafët 3 deri në 6 dënohen me burgim nga tre deri në shtatë vjet, kur kryhen:

a) nga personi me funksion drejtues publik, duke shfrytëzuar varësinë hierarkike;

b) në bashkëpunim;

c) ndaj dy ose më shumë personave ose subjekteve;

ç) nëpërmjet bashkërendimit të disa institucioneve ose strukturave publike;

d) si hakmarrje për bindjet ose sjelljen politike a zgjedhore.

8. Për qëllimet e këtij neni, burimet shtetërore janë fondet, pasuria e luajtshme ose e paluajtshme, personeli, regjistrat, të dhënat jopublike, sistemet, mjetet dhe kanalet e komunikimit që administrohen ose kontrollohen nga organet qendrore e vendore, institucionet e pavarura, entet publike ose shoqëritë ku shteti apo njësitë vendore kontrollojnë kapitalin, shumicën e votave ose shumicën e organit administrues a mbikëqyrës. Përgjegjësia penale kërkon provimin e veprimit ose mosveprimit të ndaluar dhe të dashjes, si dhe të qëllimit të posaçëm kur ai kërkohet. Afërsia kohore me zgjedhjet ose ndryshimi statistikor i veprimtarisë publike, të vetëm, nuk mjaftojnë për të provuar veprën. Për kufizimet e përkohshme merren parasysh periudha, fusha territoriale dhe përjashtimet e përcaktuara shprehimisht në ligj; përfundimi ose shuarja e tyre nuk shuan ndalimet e përhershme.

9. Ushtrimi i zakonshëm, objektiv dhe i paanshëm i funksioneve publike nuk përbën vepër penale sipas këtij neni. Për veprat që synojnë ndikimin mbi zgjedhësit nuk kërkohet të provohet ndryshimi real i bindjes ose i votës. Mendimet e shprehura në Kuvend dhe votat e dhëna nga deputeti në ushtrim të funksionit mbrohen në kushtet e nenit 73, pika 1, të Kushtetutës. Për veprimet që përmbushin edhe elementet e neneve 332 ose 332/a zbatohet dispozita e posaçme për të njëjtin fakt, pa cenuar përgjegjësinë për veprime të tjera të dallueshme.”

Neni 8

Pas nenit 328/b shtohen nenet 328/c dhe 328/ç, me këtë përmbajtje:

"Neni 328/c

Organizimi i patronazhimit politik-administrativ

1. Organizimi, drejtimi ose bashkërendimi me dashje i një skeme patronazhimi politik-administrativ, duke përdorur funksionin, autoritetin ose burimet publike, me qëllim krijimin e varësisë politike, kushtëzimin e trajtimit administrativ me mbështetje politike ose ndikimin e paligjshëm mbi vullnetin politik a zgjedhor, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

2. Në kuptim të këtij neni, skema përfshin bashkërendimin e veprimeve të të paktën dy personave. Nuk kërkohet organizim formal. Veprimet mund të përfshijnë rekrutimin e personave, mbledhjen ose përdorimin e të dhënave shtetërore jopublike, ndërhyrjen në radhën ose afatin e një procedure, si dhe kushtëzimin e punësimit, rinovimit të kontratës, ngritjes në detyrë, shërbimit ose përfitimit administrativ me mbështetje politike.

Përgjegjësia penale sipas këtij neni kërkon provimin e organizimit, drejtimit a bashkërendimit të skemës, të përdorimit të funksionit, autoritetit ose burimeve publike, të dashjes dhe të qëllimit të posaçëm të pikës 1. Konstatimi i patronazhimit administrativ sipas ligjit zgjedhor nuk mjafton, i vetëm, për përgjegjësi penale.

3. Vepra e parashikuar në paragrafin 1 dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet, kur kryhet:

a) në mënyrë sistematike;

b) ndaj dy ose më shumë personave;

c) nga personi me funksion drejtues publik, duke shfrytëzuar varësinë hierarkike;

ç) nëpërmjet bashkërendimit të disa institucioneve publike;

d) nëpërmjet marrjes, nxjerrjes ose transferimit pa të drejtë të të dhënave shtetërore jopublike për profilizimin politik të personave;

dh) duke kërcënuar vendin e punës, karrierën ose interesat e personit a të familjarit të tij në marrëdhëniet me administratën.

4. Përgjegjësi sipas këtij neni mban edhe organizatori, drejtuesi ose bashkërenduesi që nuk ushtron funksion publik, kur vepron me dijeni për përdorimin e funksionit, autoritetit ose burimeve publike dhe për qëllimin e parashikuar në paragrafin 1.

5. Fshehja, fshirja, ndryshimi ose falsifikimi me dashje i gjurmëve shkresore a elektronike për të mbuluar veprën vlerësohet sipas dispozitës penale përkatëse, kur plotësohen elementet e saj. Kur nuk përbën vepër penale më vete, sjellja vlerësohet në individualizimin e dënimit brenda kushteve të këtij Kodi. I njëjti veprim ose e njëjta rrethanë nuk përdoret dy herë për rëndimin e përgjegjësisë.

6. Kontakti politik vullnetar, organizimi i ligjshëm partiak dhe ndjekja e kërkesave në kanale administrative të hapura në kushte të barabarta nuk përbëjnë vepër penale sipas këtij neni, kur nuk përdoret funksioni ose burimi publik për kushtëzim apo ndërhyrje të paligjshme. Nuk kërkohet të provohet se zgjedhësi ka ndryshuar bindjen ose sjelljen e tij.

7. Kur i njëjti veprim përmbush elementet e këtij neni dhe të nenit 328/a, për organizimin, drejtimin ose bashkërendimin e skemës zbatohet ky nen si dispozitë e posaçme. Për veprime të tjera të dallueshme zbatohen rregullat e përgjithshme të këtij Kodi për konkurrimin e veprave penale. Rrethanat që përbëjnë element të veprës ose të formës së rënduar nuk vlerësohen përsëri si rrethana

rënduese. Kërkesa për bashkërendimin e të paktën dy personave nuk krijon prezumim për ekzistencën e organizatës kriminale ose grupit të strukturuar kriminal; kushtet e tyre vlerësohen veçmas sipas këtij Kodi.

Neni 328/ç
Profilizimi politik i paligjshëm i zgjedhësve

1. Krijimi, organizimi, administrimi ose përdorimi me dashje dhe pa të drejtë i një baze të dhënash, aplikacioni, sistemi ose mjeti tjetër të ngjashëm, nëpërmjet mbledhjes, bashkimit ose analizimit sistematik të të dhënave personale, për të përcaktuar ose regjistruar bindjet politike të supozuara, varësitë ose pjesëmarrjen individuale në votim, me qëllim kontrollin, presionin, diskriminimin ose ndikimin e paligjshëm mbi zgjedhësit, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet. Me të njëjtin dënim dënohet marrja, nxjerrja, kopjimi, vënia në dispozicion ose transferimi me dashje dhe pa të drejtë i të dhënave personale jopublike të administruara nga organet ose entet publike, kur kryhet me qëllim mundësimin e profilizimit, kontrollit, presionit, diskriminimit ose ndikimit të paligjshëm politik a zgjedhor ndaj personave.

2. Vepra e parashikuar në paragrafin 1 dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet, kur kryhet:

a) duke shfrytëzuar aksesin që personi e ka për shkak të detyrës ose autorizimit në regjistra ose sisteme publike;

b) nga personi i ngarkuar me administrimin ose sigurinë e këtyre regjistrave a sistemeve;

c) në bashkëpunim, me ndarje detyrash për kryerjen e veprës;

ç) nëpërmjet përpunimit sistematik të të dhënave në shkallë të gjerë.

Për vlerësimin e shkallës së gjerë merren parasysh numri i personave të prekur, vëllimi dhe lloji i të dhënave, kohëzgjatja e përpunimit dhe shtrirja territoriale.

3. Mbajtja nën kontroll, mirëmbajtja, vënia në dispozicion, transferimi ose rikrijimi me dashje i bazës së të dhënave, aplikacionit, sistemit ose mjetit të parashikuar në paragrafin 1, për qëllimin e ndaluar në atë paragraf, dënohet sipas paragrafit 1 ose, sipas rastit, paragrafit 2. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur mjeti është krijuar përpara hyrjes në fuqi të ligjit, vetëm për veprimet e kryera pas kësaj date.

4. Përpunimi manual i organizuar përfshihet në këtë nen njësoj si përpunimi i automatizuar. Nuk përfshihet përpunimi i ligjshëm i të dhënave për organizimin vullnetar të fushatës, administrimin e votimit, vëzhgimin, ankimin, auditimin ose hetimin zgjedhor. Ruajtja dhe administrimi i provave nga organet kompetente, sipas ligjit, nuk përbën veprën e parashikuar në këtë nen.

5. Ndalimet administrative të ligjit zgjedhor nuk zëvendësojnë elementet e veprës penale të përcaktuara në këtë nen. Publikimi i ligjshëm i të dhënave nuk lejon përdorimin e tyre për qëllimet e ndaluara në pikën 1. Nuk kërkohet të provohet ndryshimi real i votës ose i bindjes së personit. Provohen në çdo rast veprimi ose përpunimi pa të drejtë, dashja dhe qëllimi i posaçëm. Përdorimi i ligjshëm i të dhënave për pjesëmarrjen vullnetare në veprimtarinë politike dhe ruajtja e ligjshme e provave nga organet kompetente nuk përbëjnë këtë vepër.”

Neni 9

Pas nenit 328/ç shtohet neni 328/d, me këtë përmbajtje:

"Neni 328/d

Kryerja dhe përfitimi i pagesave publike të ndaluara gjatë periudhës zgjedhore

1. Urdhërimi, autorizimi ose ekzekutimi me dashje i një pagese nga fondet publike, gjatë periudhës dhe brenda fushës së zbatimit të ndalimit zgjedhor, nga nëpunësi autorizues, nëpunësi zbatues, punonjësi i strukturës përgjegjëse për thesarin ose çdo person tjetër që, sipas ligjit, ka detyrë konkrete në miratimin, kontrollin ose kryerjen e pagesës, kur e di se pagesa është e ndaluar shprehimisht nga Kodi Zgjedhor ose se ajo realizon një përfitim të krijuar nga një masë e miratuar apo e nxjerrë në kundërshtim me një ndalim të shprehur të atij Kodi dhe pagesa nuk mbulohet nga një përjashtim ligjor, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

2. Me dënimin e parashikuar në pikën 1 dënohet edhe personi që, duke pasur detyrimin ligjor dhe mundësinë konkrete për ta ndaluar pagesën, lejon me dashje kryerjen e saj pas njoftimit të një vendimi të ekzekutueshëm të organit zgjedhor ose gjykatës kompetente, të nxjerrë në bazë të ligjit, që ndalon atë pagesë. Vendimi identifikon pagesën ose kategorinë e përcaktuar të pagesave dhe detyrimin që i ngarkohet personit; ai nuk mund të krijojë një ndalim material të ri përtej ligjit.

3. Kërkimi, pranimi ose marrja me dashje e një pagese të parashikuar në pikën 1, nga personi fizik përfitues ose nga personi që vepron në emër ose në dobi të një shoqërie tregtare, organizate, enti ose personi tjetër juridik, kur personi ka dijeni për faktet që e bëjnë pagesën të ndaluar dhe për ndalimin ligjor të zbatueshëm, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet. Përgjegjësia nuk lind vetëm nga kreditimi automatik i llogarisë, statusi i përfituesit ose marrja e pagesës pa këtë dijeni.

4. Veprat e parashikuara në pikat 1 deri në 3, kur kryhen sipas një plani të përbashkët me ndarje rolesh ndërmjet dy ose më shumë personave, më shumë se një herë ose nëpërmjet dokumentacionit të falsifikuar për të fshehur natyrën e ndaluar të pagesës, dënohen me burgim nga tre deri në shtatë vjet. Falsifikimi si mënyrë e kryerjes së të njëjtit fakt nuk përdoret përsëri për rëndimin e përgjegjësisë; për veprime të tjera të dallueshme zbatohen rregullat e përgjithshme të këtij Kodi.

5. Për qëllimet e këtij neni provohen ndalimi ligjor konkret, periudha e zbatimit, lidhja e pagesës me masën e ndaluar, detyra dhe mundësia konkrete e veprimit të autorit, dashja dhe dijenia e kërkuar. Parashikimi i shpenzimit në buxhet, ekzistenca e një urdhri administrativ ose ndërmjetësimi i një subjekti tjetër nuk e përjashtojnë përgjegjësinë kur provohen këto elemente. Ky nen nuk vendos një ndalim të përgjithshëm të pagesave publike gjatë zgjedhjeve dhe nuk zbatohet për pagesa që lejohen nga ligji, përfshirë përmbushjen e detyrimeve të ligjshme të maturuara, për aq sa ndaj tyre nuk zbatohet një ndalim ligjor i posaçëm.

6. Për personin juridik zbatohen kushtet, përjashtimet dhe dënimet e legjislacionit për përgjegjësinë penale të personave juridikë, pa përjashtuar përgjegjësinë individuale të personit fizik. Kthimi i shumës ose konfiskimi bëhet sipas bazës dhe procedurës ligjore përkatëse; kthimi nuk e shuan vetvetiu përgjegjësinë penale.

7. Kur i njëjti veprim përmbush elementet e këtij neni dhe të nenit 328/a, për urdhërimin, autorizimin, lejimin ose kryerjen e së njëjtës pagesë zbatohet ky nen si dispozitë e posaçme. Për veprime të tjera të dallueshme zbatohen rregullat e përgjithshme të këtij Kodi."

Neni 10

Pas nenit 329 shtohet neni 329/a, me këtë përmbajtje:

"Neni 329/a

Hyrja ose qëndrimi i paligjshëm dhe ndërhyrja me dhunë në mjediset zgjedhore

Qëndrimi pa të drejtë ose rihyrja pa të drejtë në mjedisin e votimit ose numërimit, pas urdhrit të personit kompetent për largim, me qëllim pengimin e procesit zgjedhor, dënohet me burgim nga tre muaj deri në një vit.

Përdorimi me dijeni i një akreditimi ose autorizimi të falsifikuar për të hyrë ose qëndruar pa të drejtë në mjediset e votimit ose numërimit, me qëllim pengimin e procesit zgjedhor, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet. Përdorimi i dokumentit të identifikimit të falsifikuar vlerësohet sipas nenit 189 dhe, kur kryhet për të votuar për një person tjetër, sipas nenit 327/a.

Hyrja me dhunë në këto mjedise, me qëllim pengimin e votimit ose numërimit, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Vepra e paragrafit 3 të këtij neni, kur kryhet duke përdorur ose shfaqur armë për frikësim, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet."

Neni 11

Në nenin 330 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në paragrafin e parë, fjalët "në qendrën e tij të votimit" zëvendësohen me fjalët "sipas mënyrës së votimit që i njihet nga ligji, përfshirë votimin nga jashtë vendit".
2. Në fund të paragrafit të parë shtohen fjalitë me këtë përmbajtje:

"Në kuptim të këtij paragrafi, pengimi përfshin edhe krijimin me dashje të një radhe fiktive, bllokimin e kalimit, ndryshimin e paligjshëm të rendit të pritjes ose vonimin e qëllimshëm të votimit, si dhe organizimin ose pjesëmarrjen me dashje në grumbullime që, nëpërmjet kanosjes, frikësimit, rrethimit të hyrjes ose ndjekjes së zgjedhësve, pengojnë ushtrimin e së drejtës së votës. Për votimin postar, pengimi përfshin edhe mbajtjen, fshehjen, asgjësimin ose mosdorëzimin me dashje dhe pa të drejtë të paketës zgjedhore ose të zarfit të kthimit, me qëllim pengimin e zgjedhësit për të votuar ose për të dorëzuar votën brenda afatit ligjor. Vonesa objektive e shërbimit postar ose gabimi pa dashje nuk përbëjnë këtë vepër."

Neni 12

Pas nenit 330/a shtohet neni 330/b, me këtë përmbajtje:

"Neni 330/b

Sabotimi i procesit nga administratori zgjedhor

Bllokimi fizik i hyrjes, çaktivizimi ose ndërprerja me dashje dhe pa shkak të ligjshëm e pajisjeve ose mjeteve të domosdoshme për votimin apo numërimin, nga personi përgjegjës për administrimin zgjedhor, me qëllim ndërprerjen e procesit, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet, kur veprimi nuk përbën veprën e parashikuar në nenin 326/a.

Kur vepra sjell pasoja të rënda në mbarëvajtjen e votimit ose numërimit, ose sjell pavlefshmërinë e zgjedhjeve, dënohet me burgim nga dy deri në shtatë vjet."

Neni 13

Pas nenit 330/b shtohet neni 330/c, me këtë përmbajtje:

“Neni 330/c

Nxitja e konfliktit për ndërprerjen e procesit

Organizimi ose nxitja me dashje e një konflikti me përdorimin e dhunës ose kanosjes në qendrën e votimit, në vendin e numërimit ose pranë organit zgjedhor, me qëllim ndërprerjen e votimit ose numërimit, dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.

Kur vepra kryhet nga personi përgjegjës për administrimin zgjedhor duke përdorur funksionin e tij, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.”

Neni 14

Pas nenit 330/c shtohet neni 330/ç, me këtë përmbajtje:

“Neni 330/ç

Pengimi i zbatimit të vendimit zgjedhor

Refuzimi me dashje dhe pa shkak të ligjshëm i zbatimit të një vendimi të ekzekutueshëm të organit zgjedhor kompetent ose gjykatës kompetente në çështjen zgjedhore, nga personi përgjegjës për administrimin zgjedhor të cilit vendimi i është njoftuar dhe i ngarkon një detyrim të drejtpërdrejtë, kur ky refuzim pengon ose ndërpret votimin apo numërimin, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

Kur vepra sjell pasoja të rënda në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor ose pavlefshmërinë e zgjedhjeve, dënohet me burgim nga dy deri në shtatë vjet.”

Neni 15

Pas nenit 330/ç shtohet neni 330/d, me këtë përmbajtje:

“Neni 330/d

Mbajtja ose fshehja e materialit zgjedhor

Mbajtja, fshehja ose mosdorëzimi me dashje i kutive të votimit, fletëve të votimit, procesverbaleve ose mjeteve të aksesit, nga personi që ka detyrimin t’i dorëzojë, me qëllim pengimin ose ndërprerjen e votimit, numërimit ose transmetimit të rezultatit, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet, kur veprimi nuk është pjesë e braktisjes ose refuzimit të detyrës të parashikuar në nenin 330/a.

Kur vepra sjell pasoja të rënda në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor ose pavlefshmërinë e zgjedhjeve, dënohet me burgim nga dy deri në shtatë vjet.”

Neni 16

Pas nenit 330/d shtohet neni 330/dh, me këtë përmbajtje:

“Neni 330/dh

Fshehja e shkeljeve në dokumentacionin zgjedhor

Refuzimi me dashje, nga anëtari ose sekretari i komisionit zgjedhor, pa shkak të ligjshëm, i regjistrimit të një kundërshtimi që sipas ligjit duhet të pasqyrohet në dokumentacion, ose fshehja apo mospërcjellja e një ankimi që duhet t’i dërgohet organit kompetent, me qëllim fshehjen e një vepre penale zgjedhore ose pengimin e shqyrtimit të saj nga organi kompetent, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.”

Neni 17

Pas nenit 330/dh shtohet neni 330/e, me këtë përmbajtje:

"Neni 330/e

Mospërmbushja e detyrës për funksionimin e sistemeve dhe pajisjeve zgjedhore

1. Mosinstalimi, mosvënia në punë, konfigurimi ose përdorimi i parregullt, moskryerja e testimit, mirëmbajtjes ose ndërhyrjes së detyrueshme, si dhe mosraportimi i një defekti të njohur, të kryera me dashje dhe në shkelje të detyrës konkrete nga personi i ngarkuar me administrimin, operimin, mbështetjen teknike ose mbikëqyrjen e sistemeve ose pajisjeve zgjedhore, kur shkaktojnë pengimin e identifikimit të ligjshëm, të votimit ose të numërimit, ose humbjen, ndryshimin apo mosregjistrimin e të dhënave ose pamjeve të detyrueshme në një masë që cenon mundësinë e verifikimit të rregullsisë së procesit, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

2. Veprimet ose mosveprimet e parashikuara në pikën 1, kur kryhen nga pakujdesia në kuptim të nenit 16 të këtij Kodi dhe shkaktojnë një nga pasojat e parashikuara në atë pikë, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë ose me burgim deri në një vit.

3. Vepra e parashikuar në pikën 1, kur shkakton pamundësinë e rindërtimit ose verifikimit të rezultatit të votimit ose pavlefshmërinë e zgjedhjeve për shkak të cenimit të shkaktuar nga autori, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet. Vepra e parashikuar në pikën 2, kur shkakton një nga këto pasoja, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në dy vjet.

4. Sistemet dhe pajisjet, në kuptim të këtij neni, përfshijnë pajisjet e identifikimit elektronik të zgjedhësve, sistemet e votimit dhe numërimit elektronik, sistemet e videomonitorimit në qendrat e votimit dhe në vendet e numërimit të votave, si dhe pajisjet, programet dhe mjetet e ruajtjes ose transmetimit të të dhënave të lidhura drejtpërdrejt me to, kur përdorimi dhe veprimet konkrete mbi to janë të detyrueshme sipas ligjit dhe akteve të ligjshme për zbatimin e tij.

5. Subjekte të këtij neni janë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, anëtarët e organeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të komisioneve të zonave të administrimit zgjedhor dhe të komisioneve të qendrave të votimit, personat e ngarkuar me numërimin, operatorët teknikë dhe personat e kontraktuar, vetëm për detyrën konkrete që u është ngarkuar ligjërisht. Përgjegjësia për mbikëqyrjen kërkon provimin e detyrimit për ndërhyrje, të mundësisë reale për ta kryer atë dhe të lidhjes shkakësore të mosveprimit me pasojën; ajo nuk prezumohet nga funksioni drejtues ose anëtarësia në një organ kolegjial.

6. Defekti teknik, ndërprerja e paqëllimshme e energjisë ose e komunikimit dhe çdo shkak tjetër jashtë kontrollit të personit nuk sjellin përgjegjësi penale në mungesë të fajit. Kalimi i ligjshëm në procedurën alternative ose manuale, si dhe ndërprerja e ligjshme për mbrojtjen e sigurisë, integritetit të procesit ose fshehtësisë së votës, nuk përbëjnë vepër penale. Përgjegjësia për mosmarrjen e masave të detyrueshme të parandalimit, reagimit ose raportimit vlerësohet veçmas sipas elementeve të këtij neni.

7. Për të njëjtin veprim ose mosveprim që përmbush elementet e nenit 326/a, 327/a, 330/a ose 330/b, zbatohet dispozita përkatëse e posaçme; ky nen nuk zbatohet në mënyrë kumulative për të njëjtin fakt. Për veprime të tjera të dallueshme zbatohen rregullat e përgjithshme të këtij Kodi."

Neni 18

Pas nenit 330/e shtohet neni 330/ë, me këtë përmbajtje:

"Neni 330/ë

Moskallëzimi i veprës penale zgjedhore nga personi përgjegjës në administratën zgjedhore

1. Mosbërja, refuzimi ose pengimi me dashje dhe pa shkak të ligjshëm i kallëzimit me shkrim në prokurori ose te oficeri i policisë gjyqësore, nga personi që gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të saj merr dijeni për fakte konkrete që tregojnë kryerjen ose vazhdimin e një vepre penale që prek zgjedhjet dhe ndiqet kryesisht, kur ai ka detyrimin ligjor dhe mundësinë konkrete për ta bërë ose përcjellë menjëherë kallëzimin, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

2. Përgjegjësi sipas këtij neni mbajnë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, anëtari i Komisionit Rregullator ose i Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, nëpunësi i administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, anëtari ose sekretari i komisionit të zonës së administrimit zgjedhor ose i komisionit të qendrës së votimit, si dhe çdo person tjetër i ngarkuar me detyrë publike në administrimin, kontrollin, këqyrjen ose auditimin zgjedhor, vetëm kur detyrimi i kallëzimit i përket atij sipas ligjit.

3. Detyrimi zbatohet edhe për të dhënat e dala nga testimi ose verifikimi i sistemeve dhe pajisjeve zgjedhore, këqyrja e mëpasshme e fletëve të votimit dhe e materialit zgjedhor, verifikimi i identifikimit të shumëfishtë dhe hetimi administrativ zgjedhor. Ai vlen pavarësisht nëse personi i dyshuar është komisioner, numërues, operator, vëzhgues, funksionar publik, përfaqësues i subjektit zgjedhor ose person tjetër dhe edhe kur autori nuk është identifikuar.

4. Kallëzimi nuk kushtëzohet nga përfundimi i hetimit administrativ, i procesit të ankimit ose i këqyrjes, nga shpallja e rezultatit përfundimtar ose nga një vendim kolegjial, përveçse kur ligji parashikon shprehimisht ndryshe për veprimin përkatës. Njoftimi vetëm brenda institucionit nuk e përmbush detyrimin kur ligji kërkon kallëzim në prokurori ose te oficeri i policisë gjyqësore. Kur disa persona kanë dijeni për të njëjtin fakt, kallëzimi mund të bëhet bashkërisht; personi që ka dijeni të dokumentuar se faktet dhe materialet përkatëse janë kallëzuar rregullisht nuk ka detyrim t'i kallëzojë përsëri të njëjtat fakte. Faktet ose provat e reja me rëndësi kallëzohen sipas ligjit.

5. Kur vepra e parashikuar në pikën 1 kryhet për të favorizuar një subjekt zgjedhor, kandidat ose autorin e veprës penale, ose shoqërohet me urdhërimin apo ushtrimin e presionit ndaj një personi tjetër për të mos kallëzuar, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

6. Konstatimi i një shkeljeje administrative ose teknike që nuk shfaq të dhëna për vepër penale nuk krijon vetvetiu përgjegjësi sipas këtij neni. Mungesa e dijenisë, pamundësia objektive dhe gabimi pa dashje nuk përbëjnë këtë vepër. Respektohen e drejta për të mos u vetinkriminuar dhe përjashtimet nga detyrimi i kallëzimit të parashikuara shprehimisht me ligj.

7. Për të njëjtin moskallëzim zbatohet ky nen si dispozitë e posaçme ndaj nenit 300. Kur i njëjti veprim përbën fshehjen ose mospërcjelljen e ankimit sipas nenit 330/dh, nuk jepen dy dënime për të njëjtin fakt; për veprime të tjera të dallueshme të fshehjes, falsifikimit ose shkatërrimit të provave zbatohen rregullat e përgjithshme të këtij Kodi."

Neni 19

Pas nenit 332/a shtohet neni 332/b, me këtë përmbajtje:

“Neni 332/b

Fshehja e financimit zgjedhor

Personi që ka detyrimin ligjor për administrimin ose raportimin e financimit të fushatës dhe përdor me dashje dhurues fiktivë, transaksione të simuluara ose llogari të fshehta për t’i fshehur organit kompetent burimin, dhuruesin, shumën ose përdorimin e financimit, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.

Paraqitja me dashje e raporteve ose dokumenteve të rreme, nga personi që ka detyrimin ligjor për raportimin e financimit të fushatës, me qëllim fshehjen e burimit, dhuruesit, shumës ose përdorimit të financimit, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.

Sigurimi ose pranimi me dashje i financimit nga një burim i ndaluar shprehimisht nga ligji zgjedhor ose ligji për financimin e partive, duke përdorur mënyrat mashtruese të parashikuara në paragrafët 1 ose 2 të këtij neni për të fshehur burimin e financimit, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.

Veprat e paragrafëve 1-3 të këtij neni, kur organizohen ose drejtohen sipas një plani të përbashkët që përfshin të paktën dy persona, ose kryhen më shumë se një herë, dënohen me burgim nga dy deri në pesë vjet. Për të njëjtin fakt, përdorimi i dokumentit të rremë që shërben vetëm si mënyrë e fshehjes së parashikuar nga ky nen nuk ndëshkohet veçmas sipas dispozitës së përgjithshme të falsifikimit; falsifikimi i kryer si veprim i dallueshëm vlerësohet sipas rregullave të përgjithshme. Përgjegjësia e bashkëpunëtorëve vlerësohet sipas neneve 25–27 të këtij Kodi.”

Neni 20

Zbatimi në kohë dhe bashkërendimi i procedimeve

1. Për veprat e kryera përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji zbatohet neni 3 i Kodit Penal, përfshirë zbatimin e ligjit penal më të favorshëm.

2. Dispozitat që krijojnë vepra penale të reja ose rëndojnë përgjegjësinë penale zbatohen vetëm për veprimet ose mosveprimet e kryera pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

3. Provat sigurohen dhe ruhen nga organet kompetente sipas legjislacionit procedural penal. Ky ligj nuk krijon detyrim të përgjithshëm për ruajtjen ose arkivimin e bazave të paligjshme të të dhënave.

4. Referencat në legjislacionin zgjedhor zbatohen vetëm për dispozitat e tij në fuqi në kohën e kryerjes së veprimit ose mosveprimit, duke respektuar nenin 3 të Kodit Penal. As referencat, as aktet nënligjore dhe as vendimet administrative nuk mund të krijojnë ose zgjerojnë veprat penale, subjektet, format e fajit ose dënimet përtej atyre të përcaktuara shprehimisht në Kodin Penal. Shkelja administrative ose moszbatimi i një vendimi administrativ nuk përbën vetvetiu vepër penale.

5. Për të njëjtin veprim ose mosveprim, dispozita e posaçme zbatohet me përparësi ndaj dispozitës së përgjithshme që mbulon të njëjtin fakt. Kur i njëjti akt i hedhjes së votës për tjetrin kryhet si pjesë e mekanizmit të parashikuar në nenin 327/b dhe përmbush elementet e të dy dispozitave, zbatohet neni 327/b si dispozitë e posaçme ndaj nenit 327/a; neni 328/c ka përparësi ndaj nenit 328/a për organizimin, drejtimin ose bashkërendimin e së njëjtës skemë. Klauzolat e posaçme të neneve 330/b dhe 330/d respektohen përkatësisht ndaj neneve 326/a dhe 330/a. Për veprime të tjera të dallueshme dhe për cenime të pavarura të të mirave juridike zbatohen rregullat e përgjithshme të këtij Kodi. Nuk përjashtohet zbatimi i neneve 328, 328/b ose 329 kur provohen elemente dhe veprime të dallueshme. E njëjta rrethanë nuk përdoret dy herë për rëndimin e përgjegjësisë. Për

pagesat publike të ndaluara, funksionimin e pajisjeve zgjedhore dhe moskallëzimin zbatohen rregullat e posaçme të neneve 328/d, 330/e dhe 330/ë. Përgjegjësia nga pakujdesia sipas nenit 330/e provohet veçmas nga përgjegjësia me dashje.

6. Përgjegjësia penale nuk prezumohet nga konstatimi i një kundërvajtjeje administrative. Për procedimet administrative dhe penale që lidhen me të njëjtat fakte zbatohen garancitë kundër ndëshkimit të dyfishtë dhe rregullat ligjore të bashkërendimit të procedimeve. Konstatimi i veprës penale nuk sjell automatikisht pavlefshmërinë e zgjedhjeve. Zbatimi territorial dhe jashtëterritorial i dispozitave penale rregullohet nga nenet 5-8 të Kodit Penal; shtrirja administrative e ndalimeve zgjedhore jashtë vendit nuk e zgjeron vetvetiu juridiksionin penal.

Neni 21

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.